



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Duke u mbështetur në nenin 43 të Ligjit për Vetqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 47 dhe 48 të Statutit të Komunës së Klinës, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e XI-të të radhës për vitin 2015, të mbajtur me dt.30.12.2015, mori këtë:

V E N D I M

Për

Miratimin e Planit të punës së Kuvendit dhe Kalendarin e orarit vjetor të mbajtjes së mbledhjeve të Kuvendit, komiteteve obligative, komiteteve tjera dhe atyre konsultative për vitin 2016

I

Miratohet vendimi për Planin e punës së Kuvendit dhe Kalendarin e orarit vjetor të mbajtjes së mbledhjeve të Kuvendit të Komunës dhe Komiteteve të Kuvendit për vitin 2016.

II

Seancat e rregullta të Kuvendit të Komunës së Klinës do të mbahen javën e fundit të muajt. Seancat e rregullta të Komitetit për Politikë dhe Financa i paraprin Kuvendit 10 (dhjet) ditë para seancave të Kuvendit të Komunës, Komiteti për Komunitete 15 ditë para Kuvendit ndërsa komitetet tjera mbahen sipas nevojës. Komitetet Konsultative mbajnë së paku 4 takime në vit.

III

Kuvendi i Komunës së Klinës mbanë së paku 10 (dhjet) seanca brenda vitit 2015, 5 (pesë) prej të cilave duhet të mbahen gjatë gjashtëmuajve të parë të vitit.

IV

Mbledhjet plotësuese të Kuvendit dhe Komiteteve mund të mbahen në çdo kohë sipas nevojës.

V

Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë: Plani i Punës së Kuvendit si dhe Kalendari i mbajtjes së mbledhjeve të kuvendit dhe komiteteve të Kuvendit për vitin 2016.

VI

Vendimi është i plotfuqishëm me miratim në Kuvendin e Komunës dhe pas procedimit për konfirmim nga MAPL konform nenit 81 të LVL.

KUVENDI I KOMUNËS SË KLINËS

01Nr.06-6179 2015
Klinë më, 30.12.2015

